

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Myrvete Përdibuka procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit S. B. nga fshati Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP.nr.1133/2013 të datës 09.07.2013, pas mbajtjes së seancës fillestare në praninë e Prokurorit të Shtetit Elfete Purova, të akuzuarit, të dëmtuarit Sh. A. nga fshati Komuna e Prizrenit dhe përkthyesit të gjykatës Prof. Fejzullah Shatri, me datë 26.12.2014, publikisht morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

S. B. nga i ati R. dhe e ëma E. e lindur Sh., i lindur me datë “data e lindjes..” në fshatin Komuna e Prizrenit ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën fillore, punëtor i ndërtimtarisë, i martuar baba i dy fëmijëve, me numër të kartelës së identifikimit ID..... , boshnjak, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së mesme ekonomike.

ËSHTË FAJTOR

Me datë 01.03.2013 rreth orës 22:00 në fshatin Komuna e Prizrenit, i shkakton lëndime trupore të dëmtuarit Sh. A. e cila ka rezultuar me dëmtim të përkohshëm të një organi apo pjese të trupit, në atë mënyrë që derisa i dëmtuari ishte në shoqëri me bashkëshorten dhe fëmijët e tij dhe ishte duke ecur në rrugë, pasi që largohen familjarët e dëmtuarit, i akuzuari e kap për gjoksi dhe e sulmon fizikisht duke e goditur me grushte, me ç’rast shkakton lëndime të lehta trupore dhe atë ndrydhje të indeve të buta në buzë, në kërcirrin e djathtë dhe laprën e veshit të majtë të cilat lëndime kanë karakterin e lëndimit të lehtë trupor.

Këso dore ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1 të KPK.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 41, 43, 46, 73 dhe nenit 188 par.1 nën par.1 të KPK të akuzuarit i shqipton:

DENIM ME GJOBË

Në shumë prej 150 € (njëqind e pesëdhjetë euro), e cila shumë duhet të paguhet në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse dënimi me gjobë nuk ekzekutohet në afatin ligjor i njëjti do të zëvendësohet me 8 (tetë) ditë dënim burgu duke llogaritur 20 € për një ditë burg.

I dëmtuari Sh. A. nga fshati Komuna e Prizrenit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

I akuzuari obligohet të paguajnë të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, në emër të shpenzimeve të ekspertit mjeko ligjore për ekspertizë në shumën prej 20.44 €, kurse në emër të paushallit gjyqësor të paguaj 20 € në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP.nr.1133/2013 të datës 09.07.2013 kundër të akuzuarit S. B. nga fshati Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1 të KPK.

Gjykata në seancën fillestare në prezencën e palëve pasi që u lexua aktakuza nga ana e Prokurorit të Shtetit, i shpalosi dhe bëri prezantimin e të gjitha provat materiale në të cilat mbështetet aktakuza e parashtruar ndaj të akuzuarit. I akuzuari pas kësaj deklaroi se ka kuptuar aktakuzën dhe nuk e kundërshtoi provat materiale.

I dëmtuari Sh. A. pasi që nga ana e gjykatës udhëzohet për të drejtat të cilat i takojnë sipas ligjit, i njëjti deklaroi se parashtron kërkesë pasurore juridike ndaj të akuzuarit.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

I akuzuari S. B. dhe i dëmtuari Sh. F. nga fshati Komuna e Prizrenit, për shkak të mosmarrëveshjes paraprake, ditën kritike me datë 01.03.2013 në orët e mbrëmjes rreth orës 22:00 në fshatin Komuna e Prizrenit, derisa i dëmtuari ishte në shoqëri me bashkëshorten dhe fëmijët e tij duke ecur në rrugë, pasi që largohen familjarët e dëmtuarit, i akuzuari e kap për gjoksi dhe e sulmon fizikisht duke e goditur me grushte, me ç'rast shkakton lëndime të lehta trupore dhe atë ndrydhje të indeve të buta në buzë, në kërcirin e djathtë dhe laprën e veshit të majtë të cilat lëndime kanë karakterin e lëndimit të lehtë trupor.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë ku i akuzuari në shqyrtimin kryesor vullnetarisht ka pranuar fajin, për shkak së cilës fare nuk ka administruar provat. Gjykata fillimisht i shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, por nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu në tërësi është vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështete në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me kohë. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 246 të KPPK dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1 të KPK dhe për këtë gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin me gjobë duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo juridike.

Me rastin e marrjes së dënimit ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPK të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së

dënimit, duke mos e gjetur rrethanat rënduese e si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e akuzuarit, sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, rrethanat familjare të akuzuarit, që do të thotë se është mbajtes i vetëm i familjes, pendimi i thellë, gjer më tani nuk ka qenë i gjykuar, çka nënkupton se nuk ka ardhur ndesh me rregullat pozitive, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me gjobë sepse konsideron se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi udhëzimin e dëmtuarit në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë konform nenit 463 par.1 e 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.1081/2013 të datës 26.12.2014

Procesmbajtësja
Myrvete Përdibuka

Gjyqtarja
Teuta Krusha

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.